



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME SOCIALE

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Për procedurën me objekt “Shërbime për panairin “Promovimi i Tregusve Gjeografik dhe Kulturës Shqiptare në Gjenevë (SIDE EVENT)”

Për hartimin e kriterëve kualifikuese Komisioni u bazua kryesisht në:

- Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ;
- VKM Nr. 768, datë 15.12.2021, “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar
- VKM nr.285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;

Lloji i procedurës së prokurimit publik: Lloji i procedurës së prokurimit “Shërbime Sociale”, shërbimi me kod CPV: 79956000-0 [Shërbime për organizim panairi dhe ekspozite]

Objekti i procedurës: “Shërbime për panairin “Promovimi i Tregusve Gjeografik dhe Kulturës Shqiptare në Gjenevë (SIDE EVENT)”.

Burimi i financimit: Vetë Financim

Afati i kryerjes së shërbimit: Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 30 (tridhjetë) ditë duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.

Kodi Përkates në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV): 79956000-0 [Shërbime për organizim panairi dhe ekspozite]

Vlera e Fondit Limit: 13,500,000 (trembedhjetë milione e peseqinde mije) lekë pa TVSH.

Lloji i procedurës është mbështetur në bazë të nenit 100, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të nenit 5, paragrafi 2 dhe shërbimit me kod CPV: 79956000-0 [Shërbime për organizim panairi dhe ekspozite] të Shtojcës Nr.1, të VKM Nr. 768, datë 15.12.2021, “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik,



si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar.

Autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Pronësive Industriale për nevojat e institucionit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Të gjithë anëtarët e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret teknike për kualifikim dhe antarët e Njesisë së Prokurimit, konform rregullave të prokurimit, firmosën deklaratat ku deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Një kopje e deklaratave të mësipërme i bashkëlidhet dosjes së kësaj procedure.

Zhvillimi i kësaj procedure mbështetet në nenit 100, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të nenit 5, paragrafi 2 dhe shërbimit me kod CPV: 79956000-0 [Shërbime për organizim panairi dhe ekspozite] të Shtojcës Nr.1, të VKM Nr. 768, datë 15.12.2021, “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar.

Komisioni diskutoi pikat dhe kriteret e mëposhtme dhe vendosi:

1. Hartimin e dokumenteve të njoftimit të Ftesës për negociatë, kërkesat të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim.
2. Të përcaktojë kriterin e vlerësimit: Oferta që paraqet raportin më të mirë çmim-cilësi, duke marrë në konsideratë kriteret e cilësisë dhe qëndrueshmërisë për shërbimet sociale, në mbështetje të nenit 9, të VKM-së Nr.768, datë 15.10.2021, i ndryshuar.
3. Kohëzgjatja e Kontrates: **30 (tridhjetë) ditë** duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.
4. Marrjen e masave për dërgimin e Ftesës për negociim për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë APP-së (buletini i rradhës) sipas përcaktimeve në Vendimin nr.176, datë 29.03.2006.
5. Publikimi i kësaj procedure në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë APP-së www.app.gov.al, do të bëhet në buletinin më të afërt të rradhës.
6. Afati përfundimtar për paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë është deri me datë **27.05.2025, ora 11.00**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësive Industriale, para orës së përcaktuar.

Lidhur me Kriteret për Kualifikim që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë, Njësia e Prokurimit vendosi të miratojë kriteret si më poshtë.

Këto kriterë janë vlerësuar të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e procedurës. Përkatësisht, si vijon:



I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e ofertës ekonomike, sipas Shtojcës 1;
- b. Listën e çmimeve të shërbimeve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenit 87 dhe nenit 89 pika1/b të LPP, nenin 9 të VKM-së Nr.768, datë 15.10.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vleres se fondit limit**, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës për çdo adresë në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur duke u bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe në nenin 76/2 të ligjit 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. i ndryshuar



2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në **një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës.**

- a) Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, **shumat dhe shërbimet e realizuara.**
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, **shumat dhe shërbimet e realizuara.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Personeli Kryesor:

Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të grupit të punës që merr përsipër realizimin e shërbimit personelin kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, si më poshtë:

1 (një) Arkitekt

1(një) Kordinator projektesh

1 (një) Specilait IT

1(nje) Ekspert ushqimi (Kuzhiner)



Për të provuar plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë CV, diploma/licenc , çertifikata kualifikimi ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën përkatëse. Për arkitektin e mësipërm OE duhet të paraqesë kontratën e punës dhe/ose bashkëpunimit të vlefshëm për afatin e realizimit të kontratës.

2.4.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën **5 (pesë)** punonjës për periudhën Shkurt -Mars-Prill 2025. Për të provuar plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin E-sig 025 të listpagesave të deklaruara dhe të konfirmuara nga Administrata Tatimore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur duke marrë në konsideratë stafin kryesor, stafin teknik dhe atë mbështetës, natyrën e kontratës dhe volumin e saj. Personeli i kualifikuar është në përpjestim të drejtë me objektin e kontratës dhe shërbimet që priten të realizohen sidomos pjesa skenike ku do te promovohen produktet shqiptare,ku **arkitekti** per gjithë realizimin e skenes ne pjesen e dizajnit ku do te duhet te harmonizojë traditen dhe bashkekohoren, duke përçarur nje imazh te fuqishem te Shqiperise ne skenen nderkombetare te panairit te Gjeneves, e cila jo vetem qe ekspozon pasurine kulturore shqiptare, por edhe krijon nje pervojë terheqese dhe inspiruese per vizitorët . Për shkak te natyrës së kontratës, rëndësisë së panairit dhe afatit të realizimit të saj, është e nevojshme që shërbimet të kryhen nga profesionistë të fushës.Koordinatori i eventit do te jete pergjegjes per gjithë organizimin dhe koordinimin e eventet per aq dite sa do te zgjase ky event.Specilisti It do te mbuloje pjesen teknike ne lidhje me problematikat teknike te fushes teknologjike qe mundet te ndodhin gjate zhvillimit te panari.Ndersa eksperti ushqimor (Kuzhineri) do te pergatis te gjitha recetat ushqimore sipas pershkrimeve ne termat e references si dhe do tju shpjegoj pjesemarrsev perberjen e recetave.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” /ekuivalente dhe e vlefshme, lëshuar nga nje organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që



operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë dhe sigurisë së informacionit për të evituar dëmtimet që lidhen me shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të menaxhimit duke qënë se takimet janë me nivele të larta përfaqësimi kombëtar dhe ndërkombëtar.



3 KRITERET E PËRZGJEDHJES:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 20 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Kriteri 1 – Kriteret e përgjithshme të pranimit – 20 pikë

Kriteri 2 – Kapaciteti ekonomik dhe financiar – 20 pikë

Kriteri 3 - Kapaciteti teknik – 40 pikë

Kriteri 4 – Oferta ekonomike – 20 pikë

Argumentimi: Kriteret e përzgjedhjes janë vendosur bazuar në nenin 100, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 9 të VKM-së Nr.768, datë 15.10.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, mbi bazën e ofertës që paraqet raportin më të mirë çmim-cilësi.

Kriteret e vlerësimit për shpalljen e kontratës fituese janë vendosur në raport çmim-cilësi dhe janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, për shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim, duke përcaktuar shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Vendosja e këtyre kriterëve garanton mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqëron specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese.

I. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr.	Përshkrimi i Shërbimit	Specifikimet teknike	Njësia	Sasia
I	IMPLEMENTIM I INTERORIT TE SKENËS SË PANAIRIT NË GJENEVË			
1	Qilim tradicional me motive shqiptare	Qilim tradicional me motive shqiptare 450x300	copë	1
2	Elemente dekorative	Mdf 12mm, me lyerje te zeze me shkelqim. Do mbeshteten ne toke me njebazament melamine te zeze. Si element ne forme U, do te permbaje ndricim te fshehte shirit Led per te	copë	9



		ndricuar sfondin. 160x10x250 175x10x250		
3	Ekspozitore banak	Mdf 12mm, me lysterje te zeze me shkelqim. Me kanata te brendeshme me nje ndarje ne mes per magazinim ne trajte dollapi 150x65x90	Cope	4
4	Dollap i mbyllur	Mdf 12mm, me lysterje te zeze me shkelqim. Me kanata te brendeshme me nje ndarje ne mes per magazinim ne trajte dollapi 180x40x40	Cope	2
5	Raft metalik me 5 ndarje	Strukture metalike me profile hekuri 2x2, me lysterje ral 7021 Mat. 110x40x200	Cope	4
6	Raft metalik me 2 Ndarje	Strukture metalike me profile hekuri 2x2, me lysterje ral 7021 Mat. I pajisur me nje tub per vendosje kremastresh. 110x40x200	Cope	2
7	Panele me print per Sfond	Panele me printim adeziv sipas imazhit, mbeshtetje ne toke te lidhur bazamentin e elementeve dekorativ. Pa kapje ne tavan. 45m ²	Cope	1
II	PROMOVIMI PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE NËN SKEMAT E CILËSISË			
	PRODUKTET PËR DEGUSTIM			
1	Kumbulla e thatë e Shumbatit, Dibër		kg	10
2	Kërpudha e thatë, Pukë		kg	5
3	Gliko Arre, Përmet	Kavanoza 200–250 gr	copë	163
4	Vaj Ulliri Valmi, Elbasan	Shishe 1 litër	litra	10
5	Qepa e Drishtit, Shkodër		kg	50
6	Molla e Dvoranit, Korçë		kg	60
7	Gështenja e Reçit, Shkodër		kg	20
8	Vera e Pulësit, Berat	Shishe 700 ml	cope	112
9	Raki Perla, Pogradec	Shishe 500 ml	cope	48

10	Raki Mani, Boboshtice	Shishe 500 ml	cope	48
III	TREGUESIT GJEOGRAFIKË-PRODHIMET			
1	Gliko e Përmetit	Kavanoza 200-250 gr	cope	300
2	Mjalti i Bedunicës	Kavanoza 120-150 gr	cope	300
3	Kërpudha e tharë e Pukës	Qese 100 gr	cope	300
4	Vaj Ulliri i Balmit	Shishe 200-250 ml	cope	300
IV	PËRGATITJA E RECETAVE PËR DEGUSTIM TGJ			
1	Mish me kumbulla të thata të Shumbatit Dibër.	Sipas recetës në projekt	racione	80
2	Kërpudha Puke të skuqura me gjalpë.	Sipas recetës në projekt	racione	80
3	Byreçka me qepë Drishti dhe domate.	Sipas recetës në projekt	racione	80
4	Bukë me vaj Valmi dhe djathë e rigon.	Sipas recetës në projekt	racione	80
5	Kulaç me gështenja të Reçit dhe mjaltë gështenjash.	Sipas recetës në projekt	racione	80
6	Komposto molle Dvorani dhe sallatë molle	Sipas recetës në projekt	racione	80
7	Gliko arre natyrale	Sipas recetës në projekt	racione	80
V	PRODUKTET PER PROMOVIM			
1	Korniza me xhublet	(6 modele te ndryshme) 25 x 35 cm përmasë e jashtme, sipas specifikimeve ne projekt	cope	600
2	Përgatitje kornizë xhubletë për drejtorin e përgjithshëm të WIPO Daren Tang	25 x 35 cm përmasë e jashtme	cope	1
VI	TRANSPORTI TIRANË-GJENEVË -TIRANË			
1	Transport i dedikuar i materialeve të Panairit Tiranë – Gjenevë.	Transporti I produkteve ushqimore duhet të jetë ne kushte te pershtatshme per te ruajtur gjendjen fillestare produkti	kg	1 640
2	Transport i dedikuar i materialeve të Panairit Gjenevë - Tiranë.		kg	1 000



VII	PËRGATITJA E DEGUSTIMIT			
2	Pergatitja dhe sherbim catering nga resoranti tek WIPO		shërbim	1
VIII	KONSULETET E PANAIRIT			
1	Arkitekt	(projektim+montim+çmotim skene)	shërbim	1
IX	MATERIALE PROMOVUESE PER PANAIRIN			
1	Broshura (anglisht) me Logon e eventit dhe DPPI.	Broshure me format te hapur A3, e mbyllur A5 me printim 4 ngjyra. Me plastifikim mat. Leter 150 g/m2. Printim me 4 ngjyra te personalizuara per treguesit gjeografik.	cope	1000
2	Receta ushqimesh	Te plastifikuara (anglisht) format A5, me logon e eventit dhe DPPI. E lidhur në formë blloku.	copë	1000
3	Spila metalike me flamurin e RSH. Shiko detajin model në Aneksin 1.	Shiko detajin model në Aneksin 1.	copë	700
4	Ftesa zyrtare për panairin	Të plastifikuara. (Anglisht/Shqip), me logon e panairit dhe DPPI. Teksti i Ftesës e gjeni në Aneksin 1	copë	200
5	Canta me logon e DPPI	Çanta lecke të personalizuara me qëndisje ose stamp	copë	200
X	FOTOGRAF/VIDEOGRAF dhe IT PËR PANAIRIN			
1	Fotograf	Shërbimi konsiston ne 2(dy) ditët kryesore te panairit	shërbim	1
2	Videografer	Shërbimi konsiston ne 2(dy) ditët kryesore te panairit	shërbim	1
3	Teknik IT	Shërbimi konsiston ne 2(dy) ditët kryesore te panairit	shërbim	1
4	Koordinator eventit	Koordinator eventit gjate panairit	shërbim	1
5	Ekspert ushqimor (Kuzhinier)	Ekspert ushqimor i pranishem gjate panairit per te supervizuar gatimin e recetave dhe per te bere shpjegimin e tyre gjate degustimit	shërbim	1
XI	PREZANTIM I KULTURES DHE TRADITES			
1	Dy instrumentiste për eventin(Violinist)		ditë	1
2	Realizimi i nje video profesionale mbi promovimin e treguesve	Detaje të përmbajtjes së videos jepen në Aneksin 1.	shërbim	1



	gjeografikë në RSH (3 min).			
3	Ingrediente shtese	Ingrediente shtese te nevojshem per realizimin e recetave te cilet do blihen ne Gjeneve (sasia sipas specifikave te recetave)	Sherbim	1
4	Paketime per produktet ushqimore	Sipas sasise	Sherbim	1
5	Shporta apo kontenitore per ekspozimin e ushqimeve		Sherbim	1
6	Etiketa me logon e eventit dhe siglen DPPI	Etiketa me logon e eventit dhe siglen DPPI per produktet ushqimore	Sherbim	1

Argumentimi: Për shërbimet që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

MARIA SOLIS





Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri(AL)
Web Site: www.dppi.gov.al E-mail: info@dppi.gov.al